



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “TREGTI”

(Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK)

Kodi: L6-IV-23

TIRANË, 2025

Programi orientues për provimet përfundimtare për Kualifikimin Profesional “Tregti”, **Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe të 13-të, që i përket këtij niveli sipas Skeletkurrikulit përkatës.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Gjatë punës me këtë program kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimin përfundimtar, është e rëndësishme që herë pas here instruktorët të zhvillojnë teste të nxënësve me teste praktike që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të plotësojë një ofertë për klientin dhe një faturë shitje. Të hartojë dy kërkesa për furnitorë të ndryshëm dhe të zgjedhë midis dy ofertave të ardhura nga furnitorët ofertën më të mirë (duke sqaruar shkurtimisht përzgjedhjen e bërë). Të komunikojë në mënyrë etike dhe të realizojë shitje të suksesshme duke trajtuar ankesat e klientëve.	Detyra 2: Veprime të blerjes dhe shitjes në ndërmarrjen tregtare. Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve	20
2.	Të përdorë nëpërmjet skemës kasën fiskale dhe POS terminalin.	Detyra 3: Përdorimi nëpërmjet skemës i kasës fiskale dhe i POS terminalit	10
3.	Të kryejë procedurat e transportit të mallrave: rrugor, ajror, ujor dhe hekurudhor.	Detyra 4: Procedurat në transportin e mallrave	10
4.	Të shqyrtojë dhe të plotësojë kontrata në ndërmarrjen tregtare.	Detyra 5: Hartimi i kontratave në ndërmarrjen tregtare	15

5.	Të kryejë regjistrimet kontabël të shitjes dhe të blerjes Të llogarisë dhe të kontabilizojë saktë kthimet dhe zbritjet në çmim të mallrave. Të kryejë kontabilizimet e veprimeve ekonomike lidhur me TVSH- në dhe tatim fitimin në ndërmarrjen tregtare.	Detyra 6: Llogaritja dhe kontabilizimi në ndërmarrjen tregtare rregullimi i marrëdhënieve me shtetin	45
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”, në mjedise të simuluar në zyrën e firmës ushtrimore.
- Koha për realizimin e **të gjitha detyrave** duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
Në vlerësimin e kompetencave profesionale rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Rekomandohet të përgatiten paraprakisht pyetje, të cilat mund të përdoren gjatë këtij bashkëbisedimi.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrave përkatëse. Vlerësimi të kryhet duke hartuar më parë një listë kontrolli, duke vendosur pikët në varësi të peshës (rëndësisë) për secilën kompetencë ose elementë të kompetencës profesionale.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj. Gjithashtu, duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme.

Detyra 1: – “Veprime të blerjes dhe shitjes në ndërmarrjen tregtare. Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore. Nxënësit i kërkohet të plotësojnë dokumentet që përdoren gjatë një procedure blerjeje dhe shitjeje sipas formularëve të dhënë. Vëmendje të veçantë për vlerësimin e kësaj detyrë organizuesit e provimit duhet ti kushtojnë plotësimin të një oferte për klientin dhe një faturë shitje, si dhe hartimit të dy kërkesave për furnitorë të ndryshëm dhe zgjedhjes së ofertës më të mirë (duke sqaruar shkurtimisht përzgjedhjen e bërë).

Mësuesi përgatit paraprakisht situata të ndryshme në teza si p.sh: studim të rastit kur në ndërmarrjen tregtare vjen një klient i zemëruar. Cili duhet të jetë komunikimi, qëndrimi dhe kujdesi për të.

Rastet e ankesave të përgatitura paraprakisht duhet të jenë të ndryshme dhe menaxhimi dhe zgjidhja sa më efikase e situatës.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale

Detyra 2: - “Përdorimi nëpërmjet skemës i kasës fiskale dhe i POS terminalit”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore dhe për realizimin e saj nxënësit punojnë duke përdorur skemat e kasës fiskale dhe të POS terminalit që mësuesit duhet të vendosin paraprakisht në dosjet e tyre.

Nxënësit angazhohen në veprimtari konkrete pune duke identifikuar dhe respektuar radhën e komandave për kryerjen e veprimeve nëpërmjet POS terminalit apo kasës fiskale.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 3: - “Procedurat në transportin e mallrave”

Edhe kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore, ku mësuesi përdor situata të simuluar në procedurat e organizimit të transportit të mallit nga një vend në një vend tjetër. Mësuesi duhet të ketë modele të deklaratës doganore dhe dokumente të tjera të rëndësishme të procedurave të transportit të mallrave, për t`ju vënë në dispozicion nxënësve.

Nxënësit angazhohen në ndjekjen e procedurave në transportin rrugor të mallrave, në transportin hekurudhor të mallrave, në transportin ujor të mallrave dhe në transportin ajror të mallrave.

Nxënësit angazhohen në punë konkrete për përcjelljen e procedurave të transportit të mallit dhe të njihen me punët e doganës dhe të spedicionit si dhe pagesat.

Për realizimin e detyrës është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materiale kancelarie. Dokumente të përshtatshme të transportit rrugor, hekurudhor, ujor dhe ajror të mallrave.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale

Detyra 4: - “Hartimi i kontratave në ndërmarrjen tregtare”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore në shkollë dhe mësuesi përdor dokumente dhe shembuj konkretë për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në ndërmarrjen tregtare, formularë të marrë nga njësitë tregtare apo dokumente të përgatitur paraprakisht prej tij.

Nxënësit angazhohen në veprimtari konkrete pune për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në ndërmarrjen tregtare si: kontrata shitjeje apo kontratave ekonomike.

Për realizimin e kësaj detyre është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet si modele të ndryshme kontratash të ndërmarrjeve tregtare, materiale kancelarie, informacione të shkruara, ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme, kompjuter me lidhje interneti.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale

Detyra 5:- “Veprime të punës në fushën e kontabilitetit dhe rregullimi i marrëdhënieve me shtetin”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore në shkollë dhe mësuesi duhet të ketë përgatitur paraprakisht situata në formë ushtrimi përmbledhës. Për realizimin e plotë të detyrës duhet që për çdo nxënës të vihen në dispozicion dokumente me të dhëna për llogaritjen e kostove dhe çmimeve të produkteve në ndërmarrjet tregtare, dokumente për blerjen dhe shitjen e produkteve në tregun e brendshëm. Duke qenë se kjo detyrë do të përmbushë kompetencat profesionale në fushën e kontabilitetit, nxënësi duke shfrytëzuar dokumentet e vëna në dispozicion nga komisioni i praktikës (fatura tatimore, libra shitjeje dhe blerjeje, deklarata tatimore për TVSH) duhet të kryejë kontabilizimet e veprimeve të kryera në ndërmarrjen tregtare si dhe të rregullojë marrëdhënien me shtetin për to.

Duke qenë se kjo detyrë përmban më shumë kompetenca duhet të ketë peshën më të madhe të pikëve.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të mbahen në konsideratë arritjet e shprehive praktike në të gjitha hapat e punës për realizimin e detyrës.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.